

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7876
E mërkurë, 4 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Osmani: Kemi përmbushur kushtet për ta fituar statusin e vendit kandidat për në BE



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MD-ja BËN NDRYSHIME NË LIGJIN PËR BYRONË PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

FAQE 4-5

REPUBLIKA E KOSOVËS MINISTRIA E DREJTËSISË



Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka informuar publikun për zhvillimet e fundit lidhur me Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Haxhiu në një konferencë për medie ka bërë me dije se Ministria e Drejtësisë (MD) nuk ka hartuar një projektligj të ri për Byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së

pajustificueshme, por ka bërë disa ndryshime në ligjin ekzistues. Ajo ka theksuar se MD-ja do të sigurojë që zbatimi i ligjit të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me parimet kushtetuese

SHEA: KOSOVA TË ANGAZHOHET NË DIALOG, MUND TË JETË ZHGENJYES, POR PËRFAQËSON RRUGËN MË TË MIRË?

F. 3



AKTAKUZË KUNDËR DY TË DYSHUARVE PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

F. 3



OPINION

ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT, KËNDËLLJE APO MBYTJE E PAKTHYESHME E SHPRESËS

F. 5

Shkruan: Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



AKTUALE



KRASNIQI PRET NË TAKIM LAMTUMIRËS SHEFIN E MISIONIT TË OSBE-SË, E VLERËSON PUNËN E TIJ

F. 5

DNV-ja FILLON PËRGATITJET PËR MONITORIMIN E ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT

F. 5

ZATRIQI ISHTE FSHATI QË I DHA STREHË, BUKË DHE SHPIRT LUFTËS SË UÇK-SË

F. 6

TURQIA ARRESTON NJË KOSOVAR, E AKUZON PËR BASHKËPUNIM ME INTELIGJENCËN IZRAELITE

F. 7

EKONOMI



TRUSTI ARRIN VLERËN 3 MILIARDË EURO NË MENAXHIM

F. 10

KURTI: QEVERISJA E MIRË DHE E NDRERSHME PO E BËN SHTETIN TONË TËRHEQËS PËR INVESTIME

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hispanikët pëlqejnë Harrisin kundrejt Trumpit

WASHINGTON, 3 GUSHT - Kamala Harris kryeson ndaj Donal Trumpit në mesin e votuesve hispanikë dhe epërsia e saj prej 13-përqindësh në mesin e këtij grupi pasqyron faktin se ata favorizojnë gjerësisht qasjen e saj ndaj kujdesit shëndetësor dhe ndryshimeve klimatike, sipas sondazhit të "Reuters/Ipsos". Për këto çështje hispanikët pëlqejnë qasjen e zëvendës-presidentes demokratike Kamala Harris ndaj asaj të ish-presidentit republikan Donald Trump me diferenca të mëdha, 18 për qind për kujdesin shëndetësor dhe 23 për qind për ndryshimet klimatike. Sipas sondazhit të "Reuters/Ipsos", të kryer nga 21-28 gusht, çështjet kryesore për votuesit hispanikë të regjistruar përpara zgjedhjeve të 5 nëntorit përkohësisht kryesisht me ato që preokupojnë vendin më



gjerësisht, me ekonominë, imigracionin, kujdesin shëndetësor dhe ndryshimet



klimatike. Ndërsa votuesit e regjistruar në përgjithësi favorizojnë qasjen e

Trumpit ndaj ekonomisë, 45 për qind me 36 për qind, votuesit hispanikë kanë qasje të

ndryshme.

Votuesit hispanikë favorizojnë gjithashtu Harrisin në politikën e kujdesit shëndetësor, 46 për qind me 29 për qind dhe për ndryshimet klimatike, 46 për qind me 23 për qind. Trumpi ka një avantazh në politikën e imigracionit, me votuesit hispanikë që e favorizojnë atë ndaj Harrisit 42 për qind deri në 37 për qind.

Shumë votues hispanikë kanë prindër ose gjyshërit që kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara dhe të ardhurat e tyre më të ulëta se mesatarja i kanë bërë ata më të prekshëm ndaj një rritjeje të inflacionit në SHBA më 2021 dhe 2022.

Hispanikët përbëjnë rreth 14 për qind të qytetarëve amerikanë që kanë të drejtë votimi në vitin 2022, nga 9 për qind në vlerësimet e Byrosë së Regjistrimit 2005-2009.

Netanyahu e kritikon Britaninë për pezullimin e eksportimit të disa armëve në Izrael

JERUSALEM, 3 SHTATOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë të martën se Qeveria e Britanisë së Madhe ka marrë "vendim të turpshëm" kur i ka pezulluar licencat e eksportimit të disa llojeve të armëve në Izrael. Ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe, David Lammy, ka thënë të hënën se qeveria britanike i ka pezulluar 30 prej 350 licencave të eksportimit të armëve me Izraelin për shkak të rrezikut se ato mund të përdoren për të kryer shkelje të rënda të ligjit humanitar ndërkombëtar. Vendimi, i cili është marrë një ditë pasi forcat izraelite i nxorën



trupat e gjashtë pengjeve nga një tunel në Rripin e Gazës, u dënua shpejt nga një numër i ministrave izraelitë. "Ky vendim i turpshëm nuk do ta ndryshojë përkushtimin e Izraelit për ta

mposhtur Hamasin [grupin e shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian], i cili është organizatë terroriste që vrau egërsisht 1 200 njerëz më 7 tetor, përfshirë 14

shtetas britanikë. Hamasi ende po i mban mbi 100 pengje, përfshirë 5 shtetas britanikë. Në vend se të qëndrojnë përkrah Izraelit, një demokraci që mbron veten nga barbarizmi, vendimi i gabuar i Britanisë vetëm sa do ta forcojë Hamasin", ka thënë Netanyahu në një postim në rrjetet sociale. Ai ka shtuar se "me apo pa armët britanike, Izraeli do ta fitojë këtë luftë dhe do ta sigurojë të ardhmen tonë të përbashkët". Pak pasi Partia Laburiste i ka fituar zgjedhjet në korrik, Lammy ka thënë se do ta rishikonte shitjen e armëve për Izraelin për t'u siguruar se shitja është në përputhje me ligjin

ndërkombëtar.

Eksporti i armëve britanike përbën më pak se 1 për qind të totalit të armëve që importon Izraeli, prandaj ministri ka thënë se pezullimi nuk do të kishte ndikim material në sigurinë e Izraelit dhe se Britania vazhdon ta mbështesë të drejtën izraelite për vetëmbrojtje. Liderët izraelitë dhe palestinezë janë duke u hetuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit pas sulmit të 7 tetorit nga Hamasi në jug të Izraelit, ku u vranë 1 200 njerëz. Përgjigjja e Izraelit në Gazë ka bërë që më shumë se 40 000 palestinezë të vriten, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

Dhjetëra të vrarë nga sulmi rus me raketa në Ukrainën qendrore

KIEV, 3 SHTATOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky dhe Ministria e Mbrojtjes kanë thënë se Rusia ka sulmuar me raketa balistike Institutin e Komunikimeve në Poltava, në Ukrainën Qendrore, duke vrarë të paktën 41 persona dhe duke plagosur më shumë se 180 të tjerë. Zelensky dhe Ministria e Mbrojtjes kanë thënë se dy sulme raketore u kryen pak pas lëshimit të alarmit për sulme ajrore, prandaj njerëzit që ishin brenda institutit nuk kishin kohë të evakuoeshin në një

strehimore për bomba. "Një nga ndërtesat e Institutit të Komunikimeve u shkatërrua pjesërisht. Njerëzit mbetën në rrënoja. Shumë janë shpëtuar. Më shumë se 180 persona janë plagosur. Fatkeqësisht, shumë kanë vdekur. Deri më tani 41 viktima janë të konfirmuara", ka thënë Zelensky. Sulmi duket të jetë një prej më vdekjeprurësve që kanë kryer forcat ruse që kur nisi lufta në shkurt të vitit 2022. Zelensky, përmes një videoje të publikuar në "Telegram", ka thënë se po zhvillohen

operacione të shpëtimit të njerëzve të bllokuar në rrënoja. Zyrtarët ukrainas kanë raportuar për disa viktima në sulmet e kryera gjatë natës nga Rusia në Zaporizhja. Shtabi i përgjithshëm i ushtrisë ukrainase, po ashtu, ka raportuar se një e katërta e betejave me forcat ruse në 24 orët e fundit janë zhvilluar në lindje të shtetit, afër qytetit strategjik Pokrovsk në rajonin e Donjeckut. Në këtë zonë trupat ruse është raportuar se javët e fundit kanë bërë përparime të mëdha.



MD-ja bën ndryshime në Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka informuar publikun për zhvillimet e fundit lidhur me Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Haxhiu në një konferencë për medie ka bërë me dije se Ministria e Drejtësisë (MD) nuk ka hartuar një projektligj të ri për Byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, por ka bërë disa ndryshime në ligjin ekzistues. Ajo ka theksuar se MD-ja do të sigurojë që zbatimimi i ligjit të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me parimet kushtetuese

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie të martën, e ka informuar publikun për zhvillimet e fundit lidhur me Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ajo ka thënë se Ministria e Drejtësisë nuk ka hartuar një projektligj të ri për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, por ka bërë disa ndryshime në ligjin ekzistues.

Më 26 qershor të këtij viti Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm Ligjin për Byronë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, pasi gjeti se katër nene të tij ishin në kundërshtim me Kushtetutën. "Pas publikimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese më 29 korrik 2024 në rastin KO46/23, Ministria e Drejtësisë ka reaguar me urgjencë, duke nisur adresimin e gjetjeve të gjykatës. Përkushtimi ynë është ta garantojmë reformën në drejtësi, sundimin e ligjit dhe pashmangshëm luftën ndaj korrupsionit, e në këtë mënyrë të krijojmë një funksionalitet ligjor që reflekton drejtësinë dhe mbron interesin publik. Siç është theksuar, një nga triumfet më të

mëdha është konfirmimi se konfiskimi civil është kushtetues, duke e cilësuar si një instrument legjitim dhe proporcional për luftimin e korrupsionit në sektorin publik. Kjo është një fitore e qartë për shtetin e së drejtës dhe një mesazh i fuqishëm për të gjithë ata që abuzojnë me detyrën zyrtare", ka theksuar Haxhiu, duke shtuar se nuk kanë draftuar një projektligj të ri, por kanë adresuar vetëm katër çështje të cilat janë konsideruar në kundërshtim me Kushtetutën sipas GJK-së. "Çështja e parë: Adresimi i retroaktivitetit të ligjit. Çështja e retroaktivitetit të ligjit ka qenë një temë shumë e diskutuar dhe komplekse, e cila ka ngjallur debate të shumta. Gjykata Kushtetuese nuk e ka kundërshtuar parimisht retroaktivitetin e ligjit, duke lejuar aplikimin e tij në rastet kur kjo është në interesin publik dhe respekton parimin e proporcionalitetit. Megjithatë, sipas GJK-së, shtrirja e gjatë kohore e retroaktivitetit mund të krijojë sfida për palët e përfshira, duke i vendosur ato në një situatë të pamundësisë objektive për të siguruar prova për justifikimin e prejardhjes së pasurisë. Në këtë drejtim, ndryshimi i ri ka përfshirë konceptin e 'pamundësisë objektive' si një element kyç procedural, i cili ofron një mekanizëm mbrojtës për ata që



nuk mund të sigurojnë prova për shkak të kalimit të kohës ose faktorëve të tjerë objektivë. Kjo qasje e re ndihmon në garantimin e një procesi më të drejtë dhe më të qartë për të gjitha palët e përfshira në procedurën e konfiskimit. Çështja e dytë: Qartësia e periudhave kohore për verifikimin e pasurisë. Gjykata Kushtetuese ka theksuar nevojën për qartësi dhe parashikueshmëri në lidhje me periudhat kohore brenda të cilave Byroja Shtetërore mund të verifikojë pasurinë e fituar. Ndryshimet e reja në draftligj sigurojnë që periudha e verifikimit të pasurisë të lidhet vetëm me periudhën kur zyrtari publik ka qenë në funksion, duke lejuar përjashtimisht zgjatjen e verifikimit për pesë vite pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, nëse vlerësohet se pasuria është dukshëm më e lartë se të ardhurat e ligjshme. Kjo masë siguron një balancë të drejtë mes mbrojtjes së të drejtave të individit dhe detyrimit për të luftuar korrupsionin, duke garantuar se askush nuk është mbi ligjin dhe se abuzimi me pushtetin publik do të ndiqet pa kompromis", ka thënë ajo, duke

shtuar se ky përcaktim siguron një kornizë ligjore të qartë, e cila shmang pasigurinë dhe arbitraritetin në zbatimin e ligjit, duke mbrojtur zyrtarët publikë nga hetimet e pafundme. Sipas saj, Ministria e Drejtësisë do të sigurojë që zbatimimi i ligjit të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me parimet kushtetuese. "Çështja e tretë: Komisioni mbikëqyrës dhe ndarja e pushteteve. Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar që kompetencat mbikëqyrëse të Komisionit Mbikëqyrës nuk janë antikushtetuese, por ka identifikuar nevojën për ndryshimin e përbërjes së tij për ta respektuar parimin e ndarjes së pushteteve. Versioni i ri ka ristrukturuar Komisionin Mbikëqyrës, duke përfshirë tre anëtarë të emëruar nga Kuvendi, drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe drejtorin e Njësisë së Inteligjencës Financiare. Ky ndryshim synon të garantojë një mbikëqyrje të pavarur dhe të paanshme, duke respektuar standardet kushtetuese dhe duke siguruar që veprimet e Byrosë të jenë transparente dhe të drejta. Pavarësia e institucioneve është

thelbësore për ruajtjen e integritetit të proceseve ligjore dhe për forcimin e shtetit të së drejtës", është shprehur Haxhiu. Ajo ka bërë me dije se sa të pranojnë deklaratat nga Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit, e që beson brenda kësaj jave, do ta dërgojnë në Qeveri versionin me ndryshime të draftligjit. "Në këtë rast, meqë Kuvendi pas pak ditëve fillon sesionin vjeshtor, i bëjmë thirrje ta votojë sa më parë dhe pa vonesa duke pasur parasysh qëllimin e tij. Ministria do ta ofrojë mbështetjen e saj të vazhdueshme për grupin punues për finalizimin e amendamenteve të nevojshme, duke siguruar përputhshmëri me Opinionin e Komisionit të Venecias dhe standardet kushtetuese. Miratimi i këtij projektligji është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit në vend, andaj jam e bindur që jemi në rrugë të drejtë, të sigurt dhe, përkundër pengesave e sfidave gjatë rrugës, po ecim drejt forcimit të sundimit të ligjit dhe luftës së korrupsionit të pakompromis", ka thënë ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Aktakuzë kundër dy të dyshuarve për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë kundër dy serbëve të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile gjatë luftës në Kosovë më 1998-'99. Prokuroria i ngarkon të dyshuarit me inicialet M. P. dhe Zh. Z. me një sërë akuzash si vrasje, torturë, trajtim çnjerëzor, frikësim, shkatërrim të pasurisë, dëbim masiv dhe spastrim etnik të popullatës civile të nacionalitetit shqiptar në komunën e Istogut gjatë luftës së fundit në Kosovë. "Hetimet kanë zbuluar se gjatë periudhës kohore relevante për këtë aktakuzë, pati dy raste të dhunës seksuale ndaj viktimave të

nacionalitetit shqiptar. Gjithashtu, gjatë hetimeve u vërtetua se gjatë periudhës së luftës, në komunën e Istogut, rreth 5 mijë shtëpi janë djegur, rreth 250 persona janë vrarë, prej tyre 19 viktima fëmijë dhe shumë dëme të tjera materiale", thuhet në njoftim. Të dyshuarit janë duke u mbajtur në paraburgim në pritje të gjykimit, tha prokuroria. Dhjetorin e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës kishte thënë se ka ngritur gjithsej 33 aktakuza, që përfshijnë 89 persona, për krime lufte në Kosovë. Prej përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para

institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-'99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Shea: Kosova të angazhohet në dialog, mund të jetë zhgënjyese, por përfaqëson rrugën më të mirë

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ish-zëdhënësi i NATO-s gjatë kohës së luftës në Kosovë, Jamie Shea, ka vlerësuar se Kosova duhet t'i kthehet dialogut ani pse, sipas tij, ky proces mund të jetë zhgënjyese. Ai ka thënë se dialogu ka rrugën më të mirë përpara drejt zgjidhjeve afatgjatë. "Ky dialog mund të jetë zhgënjyese, por ai përfaqëson rrugën më të mirë përpara drejt zgjidhjeve të qëndrueshme dhe është e rëndësishme që Qeveria e Kosovës të angazhohet plotësisht në të", ka thënë Shea për "Klan Kosovën". Madje sipas tij, në këtë kohë tensionesh një fazë qetësie do t'u kontribuonte shumë negociatave. "Një periudhë qetësie në veri të Kosovës mund të ndihmojë në krijimin e një konteksti më të mirë për dialogun Beograd - Prishtinë, i cili duhet të rifillojë në vjeshtë me marrjen e detyrës nga lidhshipi i ri i BE-së", ka thënë Shea.

Kjo deklaratë u është referuar tensioneve të paralajmëruara, me rastin e mbylljes së objekteve të komunave ilegale serbe në

veri. "KFOR-it tashmë i është dashur të vendoset gjatë gjithë gushtit në urën e Mitrovicës për ta ruajtur sigurinë. Kështu që konsultimet e ngushta ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare në terren janë më të rëndësishme se kurrë në këtë kohë të tensionuar në rajon. Do të jetë shumë më e lehtë që strukturat paralele të shpërbëhen në mënyrë paqësore në kontekstin e dialogut Beograd - Prishtinë dhe një proces që siguron komunitetin serb për vendin e tij të ardhshëm në Kosovë", ka thënë ai.

Shea, i cili e njëjtin mirë rajonin e Kosovës sa i përket sigurisë, ka dhënë disa rekomandime ku, sipas tij, ka diçka që duhet të jetë primare. "Pas një numri incidentesh të dhunshme në veri gjatë 2 viteve të fundit, prioriteti kryesor për momentin është krijimi i besimit ndërmjet komunitetit kosovar dhe atij serb përmes një dialogu dhe një strategjie efektive komunikimi", ka thënë Shea.

Ai konsideron se veprimet që befasojnë partnerët



ndërkombëtarë nuk janë aspak të dobishme. "Ajo që sinqerisht nuk është e dobishme janë veprimet e njëanshme që befasojnë secilin dhe të cilat nuk janë të koordinuara me KFOR-in apo EULEX-in, të cilët në fund duhet të merren me pasojat dhe të ofrojnë siguri", ka thënë ai.

Më tutje, ish-zyrtari i lartë i NATO-s ka apeluar që raportet e Kosovës me aleatët duhet të ruhen. "Ajo që i ka sjellë Kosovës deri më tani është bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Kosovës dhe partnerëve të saj në Evropë dhe Amerikën e Veriut dhe ky partneritet i çmuar duhet të

ruhet. Është e vërtetë se që nga viti 2013. Beogradi dhe Prishtina janë pajtuar në parim që strukturat paralele serbe në veri të Kosovës duhet të shpërbëhen. Por gjithçka është çështje konteksti dhe koha. Duhet të shkojmë përpara dhe jo prapa", ka thënë Shea.

Serbët sërish protestojnë kundër mbylljes së institucioneve paralele

MITROVICË E VERIUT, 3 SHTATOR - Për të dytën ditë me radhë punonjësit e institucioneve paralele serbe, që së fundi u mbyllën nga autoritetet e Kosovës, kanë protestuar para objekteve ku gjendeshin këto institucione. Protestuesit, përfshirë punonjësit të komunës paralele të Mitrovicës, thanë se tubimi i tyre është paqësor dhe përsëritën se administrata e kësaj komune, që Kosova e konsideron ilegale, ka ofruar shërbime për të gjithë qytetarët.

Më 30 gusht, në një aksion në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, Policia e Kosovës mbylli pesë institucione paralele serbe. Qeveria e Kosovës tha se institucionet e mbyllura kanë funksionuar në udhëheqjen e Serbisë, duke e "cenuar kushtetutshmërinë dhe ligjet e Republikës së Kosovës".

Institucionet e mbyllura më 30 gusht ishin: Qarku i Mitrovicës së Kosovës, Komuna paralele e Mitrovicës, Komuna paralele e Zveçanit, Komuna paralele e Zubin Potokut dhe Komuna paralele e Leposaviqit.

Sasha Petroviq, udhëheqës i administratës në komunën paralele të Mitrovicës, tha se kjo komunë ka punuar pa ndërprerje që nga viti 1945, duke ofruar shërbime për qytetarët pa dallim kombësie e feje. Ai pretendoi se



autoritetet e Kosovës ua kanë ndaluar punën pa ndonjë vendim, njoftim apo shpjegim. Petroviq i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare, veçmas Bashkimit Evropian, që t'i ndihmojnë që të kthehen në punë.

Vuçina Jankoviq, kryetar i Qarkut të Mitrovicës së Kosovës, institucionit të mbyllur që ka

funksionuar sipas sistemit serb, tha se "këto nuk janë institucione paralele, por institucione që ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët".

Ai tha se po protestojnë në mënyrë paqësore, demokratike, teksa u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës që "t'i thërrasin mendjes dhe të na lejojnë të kthehemi në punë". Ai, po ashtu, kërkoi nga

komuniteti ndërkombëtar, "i cili flet për sundim të ligjit dhe mbrojtjen e minoriteteve, që të ndërmarrin hapa konkretë në përputhje me mandatin dhe misionin e tyre".

Afër vendit ku serbët protestuan më 3 shtator u panë dy automjete të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX).

Dy vetura të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë janë vendosur në afërsi të vendtakimit të serbëve të martën në mëngjes. Në disa nga objektet që më herët ishin përdorur nga institucionet, që funksionin sipas sistemit serb, ditët e fundit janë vendosur pllaka që tregojnë se tani ato do të përdoren si zyra për disa nga ministritë e Kosovës dhe departamentet e tyre.

Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar kanë kritikuar veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri, duke i cilësuar njëanshme dhe të pakoordinuara.

Në Kosovë ka komuna, kompani dhe ndërmarrje publike, çerdhe, shkolla fillore, të mesme dhe universitete publike që financohen drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë, dhe të cilat gjenden në qytetet dhe vendbanimet ku jeton komuniteti serb.

Këto institucione sipas ligjeve në Kosovë janë ilegale.

Më 2013 Kosova dhe Serbia në dialogun për normalizimin e raporteve në Bruksel kishin arritur një marrëveshje për shuarjen e institucioneve paralele, por ende kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht.

Zgjedhjet e 9 shkurtit, këndellje apo mbytje e pakthyeshme e shpresës



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Toleranca dhe urrejtja: Baca Adem Demaçi ishte i vetmi politikan shqiptar që i bindesha duke pasur parasysh kapitalin e madh politik dhe kombëtar e që nuk e kishin thuaja të gjithë këta politikanët e sotëm që, pa fije turpi deklarohen se merren me politikë. Të gjithë të burgosurit politikë shqiptar që ishin bashkë me bacën Adem në llogoren e Stara Gradishkës i kam dëshmitarë që bacën e kam respektuar shumë por se qëndrimet politike i kam mbrojtur edhe në raste kur nuk jam pajtuar me bacën. Isa Mustafa ka qenë politikan i rryer i cili të ka dëgjuar me kujdes dhe edukatë edhe kur nuk je pajtuar me te.

Hashim Thaçi përveç se ka qenë politikan i sofistikuar që kurrë nuk kenë mundur ta hedhni në shpinë, ai ka qenë një burrështetas që me vendimet, në disa raste edhe kundër bindjeve të tija ka bërë që Kosova të pavarësohet dhe të njihet me më shumë se 110 shtete sikur që ka ndërtuar infrastrukturën rrugore më të mirën në Ballkan. Si Feniksi, nga një vend i shndërruar në gërmadha, shkruam dhe hi e ka bërë të jetueshëm dhe me ardhmëri. Në përpjekje timen, si një kokërr injoranti ta mbrojtë Albin Kurtin dhe LV-në për më shumë se katër vite me shkrime e kam pushkatuar publikisht Hashim Thaçin e që, botërisht e pranoj se ka qenë gabim. Jo se Hashim Thaçi nuk e ka merituar të kritikohet, por se Albin Kurti nuk e ka merituar të përkrahet pa asnjë kriter vlerësues. Kurrë dhe asnjëherë për shkrimet kundër Hashimit nuk më ka thirrur askush që ta "ndali dorën", kurse Hashim Thaçi asnjëherë nuk më ka thënë pse po shkruaj kundër tij, përkundrazi e ka marrë shumë seriozisht kur i pata propozuar që një psikopat dhe bukëpërmbysës, e që nuk kam besuar se është i tillë, ta zgjedhë në një pozitë të lartë në fushën e të drejtave të njeriut. Pas bacës Adem Demaçi, personi që më së shumti e kam përkratur, në të gjitha mënyrat dhe me të gjitha mundësitë ishte Albin Kurti. Dhe po del se nuk kam pasur fort të drejtë. Në momentin e parë kur nuk jam pajtuar me te, kundër meje, familjes dhe KMDLNj-së e ka ndërsyer, po e shpërdoroi në këtë rast Pjetër Bogdanin, "Çetën e Zagarëve Fizikë dhe Virtual".

Albin Kurti pa asnjë emocion, korrektësi, ndershmëri dhe njerëzillëk, ka bërë llogari si të arrijë majat e pushtetit gjë që edhe e ka realizuar. Pretendimet ishin të bëhet si Hasan Prishtina, realiteti është se është shndërruar në Neron që flet shqip, serbisht dhe anglisht. Mjedisin e ka të përshtatshëm, me kabinet qeveritar ku gara bëhet se kush është hajn më i madh dhe injorant më përfaqësues dhe më i pëlqyer për Diktatorin. Ka deputetë që përveç mercenarizmit dhe servilizmit, tjera kualitete nuk kanë, janë të padenjë edhe për Kuvendin e Hajkobilles. Nderin intelektual dhe parlamentar ua shpëtojnë dy koka gjeniale të mendimit politik, Halil Thaçi dhe Dimal Basha të ndihmuar nga mentorët, Bajqinovci dhe akademik Dragoviqi, më falni, Bahtiri. Plus minus, aty diku janë. Si të pakorruptuar janë Hajnullah Çeku, baca Martin Cubi, ekstazitë hajna të Perzerenit dhe dëshmitari i Hagës. Për trimëri janë të njohur Xhelal Culla, Lenka Quko dhe Faraoni i Mitrovicës. Po të kishte një opozitë, qoftë edhe vetëm simbolikisht aktive, Albin Kurti moti do t'i ruante irvasët fitorëve të Norvegjisë, Hekuran Pramilitari do të shiste tabela të shumëzimit para Universitetit të Prishtinës "Qerim Qerimi", kjo nusja e Panxhabit do të punonte në ndonjë autoshkollë, Donika Katran Gërvalla do ta vazhdonte trajtimin e filluar shumë vite më parë, Besnik Bislimi do të certifikohet si rrenc dhe mashtrues dhe do të ligjëronte lëndën nga alkimia: "si rrenci dhe mashtruesi bëhet negociator i suksesshëm...". Me këtë opozitë fantome Albin Kurti i fiton zgjedhjet, pa ndonjë problem ndonjëse përqindja do të tkurret dukshëm. Do të martohet, a me LDK-në, a me PDK-në. LDK-në e shkërdhen më lehtë, i dorëzohet vullnetarisht, PDK-ja ka dëshirë të mos jepet lehtë, por në fund edhe ajo i lëshon poturet. LDK-ja falë Sherife Osmanit që e përgjysmoi partinë për një bythë karrige dhe të qenit rrogëtare e Albinin do të forcohet dukshëm. Votat e humbura nga LV-ja do të shkojnë edhe te PDK, ndonjëse më pak. AAK-ja nuk do ta ketë asnjë problem me pragu, ka ndryshuar arkitektura politike, me te edhe pragu. E forcuar me një njohëse të jashtëzakonshme të teorisë politike, më e fortë se Mario Adorno, Xheva Hizmaku, me një parashikues të proceseve integruese si Arbakër Namani, AAK-ja doli nga udhëkryqi i pragjeve. LDK-ja dhe PDK-ja nuk kanë bërë koalicione as me anëtarësinë e vet, lëre më me ndonjë parti tjetër. Në anën tjetër LV-ja ka bërë koalicion me prostitutat informative të RTK-së dhe me prostitutat politike të Lëvizjes Alternativa dhe Partisë "GUXO". Prandaj edhe fiton.

Albin Kurti po luan rulin rus në territorin e Kosovës, duke mos e rrezikuar me asgjë Serbinë dhe Rusinë dhe duke e rrezikuar me çdo gjë Kosovën dhe Serbinë. Urën e lbrit kurrë nuk do ta hapte sepse: "kafshatë e pakërdishme është or vëlla pushteti..." dhe sikur që dikur komunistët jugosllavë thonin: "prst damo., Trst ne damo., gishtin e japim, Trieshtën nuk e japim..." edhe Albini do të thotë: "Kosovën dhe shqiptarinë e jap, pushtetin jo...". Po, në fund do ta humbë pushtetin, pa iu dhimbur askujt, mësa që Donika Katran Shvarcit po i dhimbet Sherife Osmani.

A i sjellë veriu vota "sovrانيتit" Kurti?: Për votuesit që Albini i ka quajtur analfabetë funksionale e që janë afërsisht 90 për qind të LV-së, pa asnjë dyshim se Kurti e ka çliruar veriu dhe se sovranitetin e ka shtrirë përmes ish-proserbit Atiq, Lulëzim Adidasit, Pecit dhe Zeqirit që janë të PDK-së, por të certifikuar nga LV-ja, Policisë së Kosovës. Krejt këta kërkojnë që këtë sovranitet ta mbrojtë KFOR-i. Mendoj që pikërisht me veriu, lojën mjeshtërisht po e luan Aleksandër Vuçiq, që i ka vënuar serbët në gjumë për t' i zgjuar atëherë kur i duhen. Dhe shpejt do t' i duhen. Fijasko më e madhe politike e Kurtit është pikërisht veriu i Kosovës ku nuk ka as sovranitet e as integritet. Kurti ka rënë në kurth të kancelarit Sholc, që tani në Gjermani është lojtar rezervë. Albin Kurti po luan në

karta të djegura të mbetjeve mortore politike si Sonja Biserko dhe Nenad Čanak që qartazi e dezinformojnë Kurtin... për një pjatë gullash dhe një sutliash. Kurti duhet të flasë me opozitën për Kosovën e jo me dinosaurët në zhdukje e sipër që vijnë nga Serbia apo Llapje Sello.

Duhet të bëjë kujdes se ika përlesh: Një hajn i dikurshëm i KEK-ut, plakurush në pubertet më ka sharë pse kam shkruar kundër Albin Kurtit, andartes greke Dejona Mihali dhe të panipuluarit me vullnet të tij, Avni Deharit. Besoj se do t' i kthej përgjigje pas së cilës nuk do ta gjejë rrugën as në oborrin e vet. Kështu do të veprojë edhe me Pozharnin, Kretenin, nipin e Arkanit, hajnit të prave të Bacë Adem Demaçit, Lenja Qukos dhe Vajit në Tepsit. Asgjë nuk mbetet për atë dynja!

Udbashët dhe pushteti: Asnjëri nga udbashët që kanë torturuar të burgosura dhe të burgosur politikë shqiptar e që po rrefehen në "Debat Plus", asnjëri nga prokurorët dhe gjykatësit që kanë dënuar me shekuj dhe shekuj burg, nuk kanë kërkuar falje. Madje as Veton Surroi nuk ka kërkuar falje, si udbash politik i Jugosllavisë dhe Serbisë. Janë vlerë e shtuar e demokracisë së Albin Kurtit, po mbrohen nga ai dhe pushteti, vet dhe me kotillën e tyre bastarde. Kanë gjetur ngrohtësinë nën bythët e majmura të Albin Kurtit. Në emër të flamurit dhe bashkimit

kombëtar.

Avdi Latifi - Monolli, përmendore e amshueshme e shqiptarisë: Sa shpejtë po ikin vitet, sidomos për mbijetuesit josakrifikues. U bënë 33 vjet nga kalimi në përjetësi të atdhetarit të paepur, trimit syptrembur, shokut të urtë, nacionalistit ekzemblar, ushtarit të Gjon Serreqit dhe Marie Shllakut, Jahja Fushës, Rifat Berishës dhe Shaban Polluzhës, Azem Bejtës dhe Kamer Loshit, Tahir dhe Nebih Mehës, Ahmet Delisë dhe Adem Jasharit sikur edhe kryekomandantit, Bacë Adem Demaçi, hyjnorit, Bacë Avdi Latifi - Monolli. Zë i lirisë në Llap dhe Gollak, Mal të Zi, Maqedoni dhe Shqipëri, Luginë dhe Çamëri, gjithkund ku ka shqiptari, para 33 viteve, heshtur iku në parajsë dhe përjetësi. Në burg e hidhëronim, ai na deshte, në liri e respektonim, ai na admironte. Në burg iu bënë të tepërt, në liri na mungonte tepër. Ai e siguroi përjetësinë, ne as mbijetesën. Ishte idealist, iku si idealist, mirë që nuk e priti Kohën e Zhgënjimit të Madh. Zoti i nderon dhe shpërblen trimat dhe patriotët duke i kursyer nga zhgënjimet e mëdha, duke mos ua trazuar ëndrrat. Neve, mbijetuesve, me çdo kusht dhe në të gjitha rrethanat na ka dhënë atë që e meritojmë! Baca Avdi, më mirë e ke atje me ata shpirtat që të shoqërojnë se në këtë moçal ku mbijetojmë. Respekt dhe përkulje!



DnV-ja fillon përgatitjet për monitorimin e zgjedhjeve të 9 shkurtit

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Demokracia në Veprim (DnV), rrjeti i organizatave qeveritare që monitoron zgjedhjet, ka filluar përgatitjet për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të

Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka treguar se bordi i DnV-së ka mbajtur të martën një mbledhje ku është diskutuar për planifikimet që lidhen me vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor. "Në takimin e sotëm të bordit të

DnV-së diskutuam për planifikimet që lidhen me vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Si gjithnjë, përkushtim për të bërë më të mirën dhe për të kontribuar në zgjedhje me integritet", ka shkruar Kryeziu në "Facebook".

Zatriqi ishte fshati që i dha strehë, bukë dhe shpirt luftës së UÇK-së

RAHOVEC, 3 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka përkujtuar 26-vjetorin e betejës për Zatriqin dhe rënien heroike të tre dëshmorëve nga ky fshat, së bashku me 15 martirët e vrarë në vitin

1999. Kryetari Latifi ka thënë se Zatriqi ishte fshati që i dha strehë, bukë dhe shpirt luftës së UÇK-së e që kontribuoi shumë për çlirimin e atdheut. "Vepra e dëshmorëve rron

përjetësisht në kujtesën tonë dhe në histori! Mazllum Kastrati, Xhafer Vehapi dhe Esat Kastrati nga Zatriqi u pavdekësuan me pushkë në dorë në betejën e 3 shtatorit 1998, duke i dhënë nder, kuptim dhe

aromë të veçantë lirisë së këtij trualli, e cila u fitua me jetë dhe me gjak. Lufta dhe heroizmi i djemve më të përkushtuar të UÇK-së do të na bëjnë krenarë sot dhe në të ardhmen!", ka theksuar Latifi.



Policia fillon së zbatuari planin operativ "Siguria në shkolla"



MITROVICË, 3 SHTATOR - Me fillimin e vitit shkollor Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për zbatimin e planit operativ "siguria në shkolla". Bazuar në planin operativ dhe vlerësimet të bëra me qëllim të parandalimit dhe ofrimit të sigurisë do të ketë angazhime policore me fokus në zonat rrugët afër shkollave ashtu edhe në hapësirat përreth objekteve shkollore. Në zonat afër këtyre shkollave policia do t'i shtojë masat e sigurisë sidomos në intervalet kohore të ardhje-vajtjes së nxënësve të klasave të para dhe

parashkollorëve. Sipas planit, nëpër shkolla fillore dhe të mesme do të angazhohen edhe zyrtarë policorë, përfshirë edhe zyrtarë policorë në roba civile. Qasja policore për ofrim të sigurisë në shkolla do të vazhdojë në bashkërendim me autoritete edukativo-arsimore si në nivel të drejtorive komunale të arsimit, po ashtu të drejtorive të shkollave. Policia apelon te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që t'i respektojnë rregullat e trafikut rrugor me fokus rrugët në zonat dhe objektet e shënuara "Kujdes shkolla".

Rama vendos gurthemelin e një shkolle tjetër në kryeqytet



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vendosur gurthemelin e një shkolle tjetër. "Pas nisjes së shkollës së re në lagjen Mati 1 dy javë më parë, tani është radha për shkollën e re në lagjen Sofalia. Kjo lagje nuk ka pasur një shkollë fillore

të mesme të ulët, por tani pritjes i erdhi fundi", ka thënë Rama. Ai ka theksuar se me ndërtimin e kësaj shkolle fëmijët nuk do të kenë nevojë ta ndjekin mësimin në lagje të tjera, por do ta kenë shkollën e re shumë afër. "Prindërit do të kenë lehtësime

sepse nuk do t'i vozisin fëmijët e tyre në distanca të largëta për shkollim", është shprehur Rama, duke shtuar se do të ketë shkollim cilësor, kushte moderne për nxënësit e prindërit, mësim tërëditor, më pak ngarkesë për prindërit dhe përmirësim i komunikacionit.

Shpërndahen 74 motokultivatorë për fermerët e Kamenicës

KAMENICË, 3 SHTATOR - Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kamenicë ka bërë shpërndarjen e 74 motokultivatorëve për fermerët përfitues. I pranishëm ishte edhe kryetari Kadri Rahimaj i cili së bashku me drejtorin Shpend Morina uruan fermerët përfitues. I pari i komunës ka thënë se janë duke u munduar ta lehtësojnë punën e fermerëve duke shpërndarë mjete të tilla.

Edhe drejtori Morina theksoi se fermerët e sektorëve, kryesisht të perimtarisë dhe pemëtarisë, tani do ta kenë më të lehtë t'i kultivojnë këto kultura. Këta fermerë përfitues, një ndër ta është nga komuniteti serb, kanë përfituar këto mjete nga marrëveshja ndërmjet komunës së Kamenicës në bashkëpunim me shoqatën 'Islamic Relief Kosova', marrëveshje kjo e cila ka vlerën 128.804,35 euro.



Qyteti i Gjilanit pritet të bëhet me objekt të ri të Stacionit të Autobusëve

GJILAN, 3 SHTATOR - Qyteti i Gjilanit pritet ta ketë objektin e ri të Stacionit të Autobusëve, me infrastrukturë moderne dhe kushte më të mira pune e operimi. Kryetari i komunës së

Gjilanit, Alban Hyseni, tha se Stacioni i Autobusëve po bëhet realitet falë bashkëpunimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ministrin Elbert Krasniqi. "Një nga

projektet me vlerë të madhe për qytetin, që sjell ndryshimet e nevojshme infrastrukturore dhe funksionale po fillon të realizohet këtë vit", tha Alban Hyseni.



Osmani: Kemi përmbushur kushtet për ta fituar statusin e vendit kandidat për në BE

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takim shefin e ri të Zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadorin Aivo Orav. Presidentja i uroi mirëseardhje dhe sukses ambasadorit Orav përgjatë mandatit të tij, gjersa ritheksoi përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm të Republikës së Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Presidentja Osmani ka thënë

se Kosova vazhdon të jetë në ballë të reformave në të gjitha fushat, duke harmonizuar legjislacionin e saj me atë të BE-së, si dhe duke qenë plotësisht e bashkërenduar me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së. Tutje, presidentja theksoi se Kosova ka mbushur të gjitha kushtet për ta fituar statusin e vendit kandidat të BE-së. Në takim u diskutua edhe për zhvillimet e fundit në

vend, duke përfshirë sigurinë si dhe bashkëpunimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Bashkimit Evropian me qëllim të përmbushjes së objektivave të përbashkëta. Në këtë frymë, presidentja Osmani ka përsëritur rëndësinë e madhe të trajtimit të shteteve aspiruese bazuar në merita dhe në përfaqimin e vlerave që qëndrojnë në themelet e BE-së.



Turqia arreston një kosovar, e akuzon për bashkëpunim me inteligjencën izraelite



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Policia turke ka arrestuar një shtetas të Kosovës i cili akuzohet se ka transferuar para tek operativët e agjencisë izraelite të inteligjencës Mossad në Turqi, raportoi agjencia shtetërore turke e lajmeve, "Anadolu".

Autoritetet e Kosovës thanë se janë informuar zyrtarisht nga Turqia për këtë rast.

I arrestuari në Stamboll është identifikuar si Liridon Rexhepi nga Kosova. Ai kishte hyrë në Turqi më 25 gusht, u ndalua të premtën e kaluar dhe të martën zyrtarisht u arrestua, tha "Anadolu".

Agjencia turke tha se Rexhepi, gjatë marrjes në pyetje, ka pranuar

se ka bërë transferime të parave. Sipas "Anadolu", agjencia turke e inteligjencës dyshon se Rexhepi ka lehtësuar transferet financiare nga shtetet e Evropës Lindore, kryesisht nga Kosova, për tek agentët e Mossadit në Turqi.

Paratë e transferuara nga Rexhepi raportohet të jenë përdorur për mbledhje të informacioneve në Siri, për kryerjen e operacioneve psikologjike kundër palestinezëve dhe koordinimin e operacioneve që lidhen me dronët.

Raportohet se Rexhepi përdori shërbime për transferimin e parave për në Turqi. Kur arriti në këtë shtet, paratë u shpërndanë tek operativët në terren, të cilët në këmbim i dërguan këto para tek

asetet në Siri, shpesh duke përdorur kriptovaluta për t'i realizuar këto transfere.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie në Prishtinë më 3 shtator, tha se institucioni që ajo drejton ka pranuar pyetje nga Turqia lidhur me këtë rast. "Në këtë drejtim na kanë dërguar edhe pyetje me shkrim për rastin në fjalë", tha Haxhiu.

Ajo shtoi se nuk mund të japë shumë informacione, sepse rasti është i ndjeshëm. Megjithatë, MD-ja, shtoi ajo, do të dalë me një deklaram, ku do të përfshihen informacionet që mund të ndahen me publikun për këtë

rast.

Haxhiu, po ashtu, tha se bashkëpunimi juridik ndërmjet Kosovës dhe Turqisë është i mirë. Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe atë të Punëve të Brendshme të Kosovës lidhur me këtë rast, por ende nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu, REL-i i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes të Izraelit, por as nga ky institucion nuk kanë kthyer përgjigje.

Që nga janari autoritetet turke kanë arrestuar dhjetëra persona, përfshirë edhe hetues privatë, në akuzat se kanë mbledhur të dhëna për individë, kryesisht për palestinezë që jetojnë në Turqi, dhe ato të dhëna ia kanë dërguar

inteligjencës izraelite.

Izraeli nuk i ka komentuar arrestimet e bëra në Turqi.

Që nga nisja e luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë, presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka qenë një prej kritikëve më të zëshëm të veprimeve të ushtrisë izraelite dhe e ka lavdëruar Hamasin, duke thënë se është një grup çlirimtar.

Në maj Turqia ndaloi të gjithë tregtinë me Izraelin dhe ka aplikuar që të bëhet pjesë e një rasti të gjenocidit kundër Izraelit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Krasniqi pret në takim lamtumirës shefin e misionit të OSBE-së, e vlerëson punën e tij

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka pritur në takim lamtumirës shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport. "Gjatë

mandatit të tij, ambasadori Davenport është angazhuar shumë në mbështetjen e institucioneve tona dhe në avancimin e demokracisë së shtetit të Kosovës, për çka PDK-ja është shumë mirënjohëse. Ambasadorin

Davenport e falënderova për bashkëpunimin e ngushtë në këtë periudhë dhe i urova suksese në secilin angazhim të mëtejshëm. Kontributi i tij për Kosovën do të mbetet i vlerësuar!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Kurti: Qeverisja e mirë dhe e ndershme po e bën shtetin tonë tërheqës për investime

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka folur të martën për investimet e huaja direkte gjatë qeverisjes së tij. Ai ka thënë se mesatarja vjetore e investimeve të huaja direkte gjatë qeverisjes së tyre është 705.6 milionë euro apo 2.4 herë më shumë sesa mesatarja vjetore gjatë qeverive të kaluara e cila

është 299.8 milionë euro nëse e marrim nga viti 2007 e këtej. “Qeverisja e mirë dhe e ndershme, me besueshmëri dhe kënaqshmëri të lartë qytetare, sundimi i ligjit, përparimi demokratik, stabiliteti institucional, reformat ekonomike, përgjegjshmëria fiskale, politikat tatimore të përshtatshme, mbështetja e

investimeve përmes garantimit të kredive, fuqia punëtore e kualifikuar, e me skemat e punësimit të subvencionuara nga qeveria po e bëjmë shtetin tonë një destinacion përherë e më shumë tërheqës për investime dhe opsion gjithnjë e më të favorshëm për investitorë të huaj”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.



BSPK-ja kujton grevën historike, kërkon veprime urgjente nga qeveria

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në përvjetorin e 34-t të Grevës së Madhe të 3 Shtatorit 1990, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka rikujtuar rëndësinë historike të kësaj greve e cila shënoi një moment kyç në luftën për autonomi dhe të drejta njerëzore në Kosovë.

Greva, e organizuar nga BSPK-ja, përfshiu punëtorë, studentë dhe qytetarë nga të gjitha shtresat e shoqërisë, duke qenë simbol i rezistencës paqësore kundër



regjimit shtypës serb. “Greva e Madhe e 3 Shtatorit 1990 tregoi botës se si duhen mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe se si duhet kundërvënë masave shtypëse në mënyrë paqësore”, thuhet në njoftimin e BSPK-së. Greva jo vetëm që kërkoi kthimin e autonomisë së Kosovës, por edhe mbrojtjen e institucioneve kulturore dhe arsimore shqiptare. Në njoftimin e BSPK-së theksohet se pavarësisht se sot Kosova gëzon demokraci dhe

pavarësi, mirëqenia ekonomiko-sociale e punëtorëve mbetet e pamjaftueshme. “Përkitazi me këtë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës thërret Partnerin e vet Social - Qeverinë - ta nisë dialogun e mirëfilltë social”, thuhet në njoftim. BSPK-ja kërkon konstituimin e Këshillit Ekonomiko-Social dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke theksuar nevojën për ta dëgjuar zërin e sindikatave në këto procese.

Trusti arrin vlerën 3 miliardë euro në menaxhim



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) e arriti për herë të parë vlerën e 3 miliardë eurove të mjeteve neto në menaxhim në fundin e gushtit 2024. Gjatë periudhës janar-gusht 2024 mjetet në menaxhim u

ngritën për më shumë se 300 milionë euro krahasuar me fundvitin 2023. Ngritja e këtij tetëmuajori erdhi nga kontributet e reja (rreth 200 milionë euro) dhe kthimi nga investimet (rreth 165 milionë euro). Njëkohësisht rreth 60 milionë

euro u zbritën nga fondi për pagesat mujore të pensioneve dhe shpenzimet e tjera. Prej fillimit të operimit të FKPK-së më 2002, njëmiliardëshi i parë i mjeteve neto në menaxhim është arritur më 2014, ndërsa

dymiliardëshi më 2021. Vlerësuar në tërësi, mjetet që FKPK-ja i ka aktualisht në menaxhim përbëhen prej pagesave të kursimeve pensionale nga kontribuuesit (rreth 78 % ose 2.34 miliardë euro) dhe kthimi nga investimet (rreth 22 % ose

660 milionë euro). Përveç mjeteve aktuale në menaxhim, prej themelimit e deri më tani janë tërhequr edhe rreth 675 milionë euro nga përfituesit e FKPK-së (përfshirë këtu edhe rreth 200 euro milionë nga tërheqja e parakohshme për 10%-shin).

Një person deponon 2 000 euro të falsifikuara në një bankë në Prizren

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se një person në një bankë në

Prizren ka deponuar 2 000 euro para të falsifikuara. Rasti është raportuar të hënën në

orën 11:00. “Është raportuar se nga klienti janë deponuar 2 000 euro para të falsifikuara.

Monedhat janë sekuestruar dhe rasti është duke u hetuar”, thuhet në raportin e policisë.



Në shtëpinë e Servantesit

Nëse madrilenët mburren me Puerta de Alcalá, në Alcalá de Henares Puerta de Madrid funksionon ende sot si një hyrje monumentale në qendrën historike. Ndoshta kjo portë nuk është aq e famshme sa ajo e kryeqytetit, por përveç rëndësisë së saj historike, ajo ka një vlerë të veçantë për kinefilët: Stanley Kubrick e rrethoi me qindra shtesa dhe e shndërroi në një hark romak për xhirimet e Spartakut.

Ky cep i Alcalá de Henares është një pikë fantastike për të kaluar muret e lashta mesjetare dhe për të hyrë në rrugët që i përkasin një kompleksi, të njohur si një vend i trashëgimisë botërore. Ka shumë fjalë që të vijnë menjëherë në mendje kur mendon për këtë vend, në komunitetin autonom të Madridit. Për shembull, universitet dhe komplutense, terma që aludojnë në dy momente kyçe në historinë lokale: themelimi i universitetit të Alcalá-s në kohën e mbretërve katolikë; dhe origjinën e tij të largët, në epokën romake.

Në fund të shekullit të parë para Krishtit, romakët themeluan Complutum, një vendbanim që u zhvillua me kalimin e kohës dhe mbetjet e të cilit janë ende të dukshme në jug të qytetit. Në qendër mund të vizitoni muzeun arkeologjik dhe paleontologjik i cili ruan shumë gjetje, duke përfshirë mozaikët e mëdhenj që zbukurorin shtëpitë. Kujtesa e asaj epoke të largët ngjallet edhe nga Via Complutense, e cila ende përdoret dhe që ndjek gjurmën e rrugës së lashtë romake që lidhte qytetet Augusta Emerita dhe



Caesar Augusta, sot Merida dhe Zaragoza.

Ndër të tjera, rruga Complutense është e veshur me muret e lashta të Alcalá-s dhe dhjetëra skulptura bashkëkohore nga artistë si Eduardo Úrculo, Amadeo Gabino dhe Pablo Serrano, duke dhënë jetë një dialogu artistik shumë sugjestionues, midis të shkuarës dhe së tashmes. Universiteti ishte dhe është ende elementi më i spikatur. Kardinali i fuqishëm Cisneros e themeloi atë në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë: universiteti i parë i studimeve humaniste në Spanjë, i cili favorizoi zhvillimin e të gjithë qytetit. Këtë rol universiteti e luan edhe sot, sepse popullsia studentore, me prejardhje shumë të larmishme, vazhdon të jetë e madhe.

Natyrisht, monumentet janë gjithashtu një shenjë dalluese e identitetit të Complutenses, duke filluar nga kolegji i San Ildefonsos. Duke vëzhguar fasadën e tij imponuese nga Plaza San Diego, zbulojmë disa skulptura që janë simbol i njohurive të dhëna në këtë qytet. Duke kapërcyer derën hyjmë në oborret e Santo Tomás de Villanuevas, të filozofëve dhe në atë tregjuhësh, rreth të cilit u shpërndanë klasat dhe dhomat, të cilat sot strehojnë rektoratin dhe shërbejnë si skenë për ngjarje të tilla si dhënia e çmimit Cervantes. Vlen të përmendet gjithashtu kapela e San Ildefonsos, ku ndodhet mauzoleumi i kardinalit Cisneros. Kapela, megjithatë, është bosh: eshtrat e kardinalit gjenden në katedralen e afërt të Shën Justo dhe Pastor, një tempull

me origjinë mesjetare, pamja aktuale e të cilit është kryesisht për shkak të rinovimit të promovuar nga vetë kardinali.

Në realitet, transformimi i dëshiruar nga Cisneros shkoi shumë përtej ndërtesave dhe monumenteve.


Alcalá karakterizohet nga koncepti një qyteti total universitar: jo vetëm klasat u ndërtuan për të mbajtur leksione ose dhoma për të strehuar studentët, por edhe infrastrukturën për administrimin e universitetit dhe kujdesin për të sëmurët, dhe instituti kishte ligjet e veta specifike.



Fryma e komunitetit arsimor ende mbijeton dhe shumë fakultete mund të shihen të shpërndara rreth qendrës. Këta tempuj të dijes magjepsin fort, sepse zënë hapësira historike.

Dega e arkitekturës, për shembull, është në manastirin e Shod Carmelites, ndërsa dega e ekonomisë është në kolegjin e San Francisco de Paula. Alcalá de Henares ia vlen të vizitohet vetëm për të marrë frymë në këtë atmosferë universitare.

Por ajo pret gjithashtu një atraksion tjetër që tërheq qindra turistë çdo ditë të vitit: vendlindja e Miguel de Cervantes, e cila është në Calle Mayor de Alcalá, rruga më e gjatë me portikë të dyfishtë në Spanjë. Miguel de Cervantes erdhi në botë në 1547 dhe kaloi vitet e tij të para këtu. Vendlindja e tij u restaurua pak kohë më parë për të rikrijuar kushtet e jetesës së një familjeje të pasur të kohës.

Rodrigo de Cervantes, babai i shkrimtarit të ardhshëm, ishte një kirurg që ndoshta erdhi në qytet për të punuar në spitalin e Antezanës, gjithashtu në Calle Mayor dhe ngjitur me shtëpinë. Vizita në shtëpinë e shkrimtarit është e detyrueshme dhe falas. Mobiljet historike dhe botimet e Don Kishotit nga periudha dhe gjuhë të ndryshme janë ekspozuar këtu. Fisniku mendjemprehtë dhe pronari i tij shpirtmirë kujdesen për mirëpritjen e vizitorëve. Skulpturat prej bronzi në madhësi reale të të dyve janë në një stol në Calle Mayor. Duket se ata po pushojnë pas shumë aventurash, teksa presin që pranë tyre të ulet ndonjë i panjohur, pasi janë kthyer në atraksionin më të fotografuar në qytet. / La Vanguardia – Bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Rrahmani dhe Rrudhani: Duam fitore ndaj Rumanisë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të martën e zhvilloi stërvitjen e dytë para ndeshjes në Ligën e Kombeve ndaj Rumanisë. "Dardanët" më 6 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" do të përballen me Rumaninë, e tri ditë më vonë me Qipron dhe këto dy ndeshje janë në kuadër të Grupit 2 të Ligës C, ku Kosova synon t'i tregojë vlerat e saj dhe ta fitojë grupin për t'u promovuar në Ligën B. Sulmuesi Albion Rrahmani pas stërvitjes ka thënë se "dardanët" janë të gatshëm ta nisin këtë garë. "Atmosfera është shumë e mirë. Krejt grupi jemi duke punuar mirë. Jemi të fokusuar 100 për qind për ndeshjen hapëse të këtyre grupeve dhe jemi të gatshëm t'i marrim tri pikët e para në

këtë grup. Shpresoj që fillimisht të më jepet mundësia e më pas do ta jap maksimumin ta tregoj veten. Jam në një moment të mirë dhe shpresoj që këtë ta kam edhe në kombëtare", ka thënë Rrahmani. "E kanë pritje mirë, duke e ditur se jam edhe transferimi më i shtrenjtë në ekipin tonë. Në dy ndeshjet e para kam shënuar dhe kam bërë një asistim dhe shpresoj të mos ndalem dhe ta ndihmojë ekipin drejt objektivave dhe ta fitojmë edhe titullin kampion", ka shtuar Rrahmani. Në fund Rrahmani pati edhe një thirrje për tifozët "dardanët": "Presim të gjithë të vijnë të na përkrahin, pasi së bashku mund të bëjmë gjëra të mëdha, tifozët në tribuna dhe ne në fushë". Pas stërvitjes foli edhe futbollisti Donat Rrudhani. Edhe ky i fundit, sikurse Albion Rrahmani, ka

konfirmuar se atmosfera është e mirë në kampin e Kosovës dhe se synim është fitorja në ndeshjen ndaj Rumanisë. "Atmosfera me Kosovën gjithmonë është e mirë. Është kënaqësi dhe krenari e madhe me u grumbulluar me Kosovën. Dje nuk isha në stërvitje, pasi kam luajtur të dielën. Sot ka qenë stërvitje e mirë dhe intensive dhe kemi punuar shumë të gjithë lojtarët. Besojmë në fitore dhe të gjithë jemi të bindur se mund ta mposhtim Rumaninë. E dimë se çka ka ndodhur në ndeshjen e fundit dhe ky është një motiv i madh për fitore", ka thënë Rrudhani. Futbollisti Rrudhani pret përkrahje edhe në ndeshjen e radhës nga "dardanët" dhe tifozët. "Dardanët" dhe tifozët janë përkrah neve si në humbje ashtu edhe në fitore dhe kjo për ne është krenari e madhe", ka deklaruar Rrudhani.



Superkupa në Rahovec i kushtohet Izet Gjinovcit

RAHOVEC, 3 SHTATOR - Të shtunën zhvillohen ndeshjet për Superkupën e Kosovës në hendboll. Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës ka vendosur që ndeshjet të zhvillohen në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec. KH Rahoveci shfaqti interesim për t'i organizuar ndeshjet e Superkupës dhe Bordi të hënën konfirmoi "vreshtarët" si nikoqirë. Prej orës 15:30 zhvillohet ndeshja e hendbollistëve në mes të Istogut dhe Ferizajt. Istogu është kampion në fuqi, ndërsa Ferizaj është fitues në fuqi i Kupës.

Prej orës 18:00 është ndeshja e hendbollistëve në mes të Rahovecit dhe Kastriotit të Ferizajt. Rahoveci është kampion, kurse Kastrioti fitues i Kupës. Bordi i FHK-së ka vendosur që ky edicion i Superkupës të njihet me emrin "Superkupa e Kosovës - edicioni Izet Gjinovci". Ky vendim u



mor për ta nderuar personalitetin dhe kontributin e ish-sekretarit të përgjithshëm të FHK-së, Izet Gjinovci, që ndërroi jetë më 5 gusht. Gjinovci për mbi dy dekada e mbajti postin e sekretarit të përgjithshëm të FHK-së. Në detyrë ishte deri në frymën e

fundit, kurse kontributi i tij për hendbollin vlerësohet i madh. Pritet numër i madh i shikuesve në Rahovec dhe, po ashtu, spektakël hendbolli. Për trofe luftojnë katër skuadrat që arritën sukses të madh në edicionin e kaluar.

SHKURT

KB Prishtina përforcohet me Josh Nzeakor

KB Sigal Prishtina po vazhdon të përforcohet për sezonin e ri në elitën e basketbollit. Në prag të Superkupës së Kosovës në basketboll, kryeqytetasit e kanë zyrtarizuar basketbollistin e radhës, Josh Nzeakor. Lajmin e kanë dhënë "bardhekaltrit" përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Ai luan në pozitën katër, teksa skuadra e tij e fundit ka qenë Birmingham Squadron në G-League. Nzeakor e pati një mesatare prej 3.2 pikësh dhe 2.2 asistimesh për ndeshje. Basketbollisti ka bërë karrierë edhe në shtete si Franca, Gjermania, Meksika e Argjentina.

Al-Itthad konfirmon transferimin e Mitajt

Klubi nga Superliga e Arabisë Saudite, Al-Itthad, ka konfirmuar edhe zyrtarisht transferimin e mbrojtësit shqiptar Mario Mitaj nga Lokomotiv Moskë. Al-Itthad konfirmoi transferimin e dy yjeve, Steven Bergwijn nga Ajaxi dhe Danilo Pereira nga Paris Saint-Germain. Megjithatë, mëngjesin e së martës klubi saudit vazhdoi zyrtarizimin e transferimeve të ditës së fundit të afatit kalimtar. I fundit i zyrtarizuar nga Al-Itthad është mbrojtësi i majtë shqiptar, Mario Mitaj, i cili transferohet nga rusët e Lokomotiv Moskës. "Nga Moskë në Jeddah. Mario Mitaj është me Al-Itthad", thuhet shkurtimisht në njoftimin e klubit saudit. Mitaj kalon tek Al-Itthadi si huazim njëvjeçar me pagesë prej 1.2 milion eurosh. Tek Al-Itthadi, Mitaj do të luajë me yje të mëdha si Karim Benzema, N'Golo Kante, Fabinho, Moussa Diaby dhe Houssem Aouar.

Lëndohet kapiteni Berat Gjimeshi

Lajme aspak të mira në prag të Ligës së Kombeve për Shqipërinë pasi, pas Armando Brojës, mund të mungojë edhe Berat Gjimeshi. Mësohet se së fundmi kapiteni ka pësuar një lëndim në stërvitjen e kombëtares. Mbrojtësi pësoi një problem muskolor që e detyroi të largohej nga kampi stërvitor i kombëtares shqiptare. Ai do t'u nënshtrohet analizave të tjera për ta parë shkallën e lëndimit.

Besfort Zeneli: Po, e kam refuzuar Kosovën dhe ndihem mirë

Mesfushori Besfort Zeneli ka folur për herë të parë në lidhje me refuzimin e kombëtares së Kosovës duke thënë se e ka marrë këtë vendim dhe se ndihet mirë tani. Ai ka thënë se po e pret ftesën e Suedisë dhe se ajo është zgjidhja e duhur për të. "Jam ftuar të Kosova, por e kam refuzuar. Tani duhet të fokusohem të luaj mirë dhe të pres ftesën nga Suedia në të ardhmen. Ndihej mirë që e kam marrë këtë vendim. Suedia është e duhur për mua. Vëllai Arbëri dhe familja më kanë mbështetur plotësisht në këtë vendim. Nuk kam pasur absolutisht asnjë problem", ka thënë Zeneli për "Sportbladet".

Andrei Ratiu: Na pret ndeshje e vështirë ndaj Kosovës

Bukuresht, 3 shtator - Rumania dhe Kosova do të përballen mes vete të premten mbrëma në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Rumunët vijjnë nga pjesëmarrja e suksesshme në "Euro 2024", derisa janë të vetëdijshëm se

në kryeqytetin e Kosovës s'do t'i pretë ndeshje aspak e lehtë. Për këtë është i vetëdijshëm edhe futbollisti rumun Andrei Ratiu. "Në shtator na presin dy ndeshje të vështira, absolutisht. Natyrisht, nga e kaluara, pasi jemi përballur me

ta, e dimë se si është të luash me Kosovën, mbi të gjitha në shtëpinë e saj. Do të jetë një takim me shumë duela, në ajër dhe në tokë. Duhet të jemi të bashkuar. Duhet të luajmë ashtu siç dimë dhe në fund të dalim nga fusha e lojës me tri

pikë të fituara", ka deklaruar futbollisti i Rayo Vallecanos për mediet rumune. Krahas Kosovës, Rumania në këtë muaj do të luajë edhe me Lituaninë, kurse "Dardanët" më pas do të kenë punë me Qipron të hënën që vjen.



Almir Ajzeraj pasi mori çmimin 'Ylli i javës': Synojmë titullin dhe Kupën

"Epoka e re"

GJILAN, 3 SHTATOR - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, po vazhdojnë ta ndajnë çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e katërt në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Drita, Almir Ajzeraj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Sunaj Keqi dhe Fatmir Mehmeti. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e katërt t'i takojë Ajzerajt, i cili, ndonëse u aktivizua në pjesën e dytë të ndeshjes, arriti ta zhblllokojë ndeshjen me golin e tij dhe, po ashtu, asistoi në një tjetër gol, duke qenë lojtar i më i vlefshëm i ekipit të tij. Almiri ishte vendimtar në arkëtimin e tri pikëve të para të FC Drita në këtë edicion të Albi Mall Superligës, që e mposhti FC Ferizajn me rezultat 3:1. Pasi mori këtë çmim, Ajzeraj



u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës. "Fillimisht është një start i mirë për ekipin tonë, meqë është ndeshja e parë në kampionat pas ndeshjeve në Evropë. Një ndjenjë mjaft e mirë që shpallim 'Ylli i javës'. Falënderoj bashkëlojtarët e mi, sepse është edhe meritë e tyre. Është e rëndësishme që kemi filluar me 3 pikë dhe do të vazhdojmë ndeshjet një pas një.

Sa i përket nivelit të Superligës, çdo vit ka rritje dhe mendoj se sivjet ka më shumë cilësi. Çdo vit gara për titull është më e vështirë dhe më konkurruese. Si çdo vit, FC Drita ka pretendimet të dalë kampion dhe ta fitojë Kupën e Kosovës. Do të shkojmë ndeshje pas ndeshje. Do të futemi në çdo ndeshje vetëm për fitore", ka thënë Ajzeraj për faqen zyrtare të FFK-së.

Atletja nga Uganda në spital pas sulmit me benzinë në Kenia

Kampala, 3 shtator - Atletja nga Uganda, Rebecca Cheptegei, ndodhet në një gjendje kritike në një spital kenian, pasi dyshohet se është lagur me benzinë nga një ish i dashur. Maratonistja 33-vjeçare, e cila garoi në Lojërat e fundit Olimpikë të Parisit, ka pësuar djegie në mbi 75% të trupit të saj, njofton policia. Ajo u sulmua në shtëpinë e saj në Kenia përëndimore, ku kishte qenë duke u stërvitur. Ka shqetësime për rastet në rritje të dhunës ndaj atleteve femra në Kenia, disa prej të cilave kanë rezultuar me vdekje. Zonja Cheptegei thuhet se është shpëtuar nga fqinjët pasi një ish-partner dyshohet se i ka derdhur benzinë dhe i ka vënë flakën në shtëpinë e saj në qytetin e vogël të Endebess. Sulmuesi i supozuar gjithashtu pësoi djegie të rënda në incidentin që ndodhi të dielën, u tha gazetarëve shefi i policisë



lokale Jeremiah ole Kosiom. Të dy po trajtohen në Spitalin Referral Moi në Eldoret, qyteti kryesor në rajon. "Çifti u dëgjua duke u grindur jashtë shtëpisë së tyre. Gjatë sherrit i dashuri u pa duke derdhur një lëng mbi gruan përpara se ta digjte", citohet të ketë thënë Kosiom. Zonja Cheptegei, nga një rajon pak përtej kufirit në Ugandë, thuhet se ka blerë një copë tokë në qarkun Trans Nzoia dhe ka ndërtuar një shtëpi, për të qenë pranë shumë

qendrave të trajnimit atletik të Kenias. Një raport i paraqitur nga një administrator lokal tha se të dy ishin grindur për një copë toke. Policia thotë se hetimet për këtë rast janë duke u zhvilluar. Zonja Cheptegei përfundoi e 44-ta në maratonë në Olimpiadën e fundit të Parisit. Ajo fitoi medaljen e artë në Kampionatin Botëror të Vrapimit në Mal dhe Trail në Chiang Mai, Tajlandë, në 2022. Në prill 2022, një tjetër femër vrapuese, Damaris Mutua, u gjet e mbytur në një shtëpi me një jastëk mbi fytyrë në qytetin e Rift Valley të Iten. Kjo erdhi disa muaj pasi vrapuesja rekord e distancave të gjata Agnes Tirop u gjet e vrarë me thikë në të njëjtin qytet. Në shënjestër kanë qenë edhe meshkujt. Dhjetorin e kaluar, një tjetër atlet nga Uganda, Benjamin Kiplagat, u vra me thikë nga sulmuesit në Eldoret.

SHKURT

Ronaldo: Deri në ditën e fundit të karrierës do të jam titullar

Portugalia ka nisur grumbullimin në kuadër të dy ndeshjeve në Ligën e Kombeve kundër Kroacisë dhe Skocisë. E gjithë vëmendja ishte te Cristiano Ronaldo, me legjendën luzitane që përfundoi në qendër të kritikave për shkak të rendimentit të tij të dobët gjatë "Euro 2024". Në konferencën për shtyp, Ronaldo theksoi edhe një herë se ndihet ende i vlefshëm për ekipin përfaqësues: "Ajo që ndiej në këto momente është se e shoh veten sërish të vlefshëm për ekipin përfaqësues. Kur ta kuptoj se nuk jam më një aset, burim për këtë grup, për këtë përfaqësues, atëherë do të tërhiqem. Unë e di se çfarë ndiej, se çfarë jam ende i aftë të bëj. Unë mendoj gjithnjë, se deri në ditën e fundit të karrierës do të jam titullar. Gjithnjë i kam respektuar zgjedhjet e trajnerit, mbase jo gjithmonë, por kjo ka ndodhur kur ata janë sjellë keq me mua. Në çdo rast që do të ketë etikë ndaj meje, sjellje profesionale, unë do t'i respektoj gjithnjë trajnerët", u shpreh Ronaldo.

Kimmich, kapiteni i ri i Gjermanisë

Futbollisti i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, është kapiteni i ri i Gjermanisë. Ky vendim u mor gjatë ditës nga selektori Julian Nagelsmann, pas pensionimit të Ilkay Gundoganit. 29-vjeçari do ta udhëheqë "Die Mannschaft" në garën e Ligës së Kombeve. Ndeshjen e parë të këtij edicioni kombëtarja gjermane do ta luajë të shtunën kundër Hungarisë. Nga viti 2016 Kimmich shiritin e kapitenit të Gjermanisë e ka bartur shtatë herë. Kombëtarja e udhëhequr nga Nagelsmann është në Grupin 3ë të Ligës A, me Hungarinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Holandën.

Suarez pensionohet nga Kombëtarja e Uruguait

Sulmuesi Luis Suarez mes lotësh njoftoi tërheqjen nga përfaqësuesja e Uruguait. 37-vjeçari saktësoi se ndeshja kundër Paraguit, e vlefshme për kualifikueset e Botërorit, në program për t'u zhvilluar këtë të premte, do të jetë e fundit për të. Sulmuesi i Inter Miamit është golashënuesi më i mirë në historinë e Uruguait me 69 gola në 142 ndeshje. Suarez bëri debutimin e tij me fanellën e ekipit përfaqësues më 8 shkurt 2007 në ndeshjen kundër Kolumbisë. Suarez ka qenë pjesë e Uruguait në katër Botërore.

Guardiola: Rodri e meriton 'Topin e Artë'

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë se do të ishte i lumtur nëse një futbollist i Cityt do të ishte fitues i "Topit të Artë". Guardiola beson se këtë çmim e meriton Rodri para Vinicius Junior dhe Jude Bellingham. "Do të isha shumë i lumtur nëse një nga lojtarët tanë do ta fitonte Topin e Artë. Kjo do të thotë shumë për lojtarët, kështu që do të isha shumë i lumtur", ka thënë fillimisht Guardiola. "Rodri e meriton Topin e Artë, por ndoshta edhe dikush tjetër. Rodri jo vetëm që ka pasur një sezon të jashtëzakonshëm, ai tashmë ka pasur shumë sezone të shkëlqyera në Ligën Premier, veçanërisht në Kampionatin Evropian të cilin e fitoi", ka thënë trajneri i Cityt.

Osimheni transferohet te Galatasaray, tifozë i rezervuan një pritje të pabesueshme

Në mënyrë të papritur Victor Osimhen zgjedh Stambollin për ta vijuar karrierën, transferohet te Galatasaray, një lëvizje surprizë në orët e fundit të merkatos, por që duket si një bekim për të gjithë palët. Napoli

e kishte nxjerrë në shitje, ishte jashtë planeve të Contes, ndërsa lojtari kërkoi me insistim një klub të rëndësishëm për ta vijuar karrierën, por klauzola e tij e lartë bëri që ekipet e interesuara si PSG-ja apo Chelsea të

tërhiqeshin. Osimhen gjeti zgjidhje në Stamboll, një huazim i thatë deri në fund të sezonit. Osimhen do të përfitojë 10 milionë euro neto në sezon. Me dhjeta mijë tifozë kishin zbarkuar në aeroport duke i

rezervuar nigerianit një pritje të pabesueshme, një atmosferë elektrizuese e cila e bëri për vete lojtarin: "Kjo është një atmosferë e pabesueshme. Është një ndjesi fantastike të jem këtu përpara një prej tifozerve më të mira në

botë. Mezi pres t'ju takoj sërish". Përpara se të transferohej te Galatasaray, Osimhen rinovoi kontratën e tij me Napolin deri në 2027, ndërsa u ul edhe klauzola e largimit në 75-80 milionë euro.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazhi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025

01.07.2024 deri më 30.09.2024

STUDIME BACHELOR	STUDIME MASTER
1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar) 2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar) 3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)	1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar) 2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)

Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR	Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER
Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar) Certifikatën e lindjes, Kopja e letërnjoftimit, Dy foto.	Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar) CV Certifikatën e lindjes Kopjen e letërnjoftimit Dy foto

www.kolegjobiznesi.com,
info@kolegjobiznesi.com

038/045/044- 500 878
049/ 048- 500 – 878
029-230-555 : 044 131027

ANKAND PUBLIK PËR SHITJEN E AUTOMJETEVE

Me datë 11.02.2022 Gjykata Themelore në Prishtinë ka marra Aktvendim me numër IV.EF.nr.2.2022 për falimentimin e kompanive Aksoy Group SH.P.K me NUI 811163617 dhe International Medicine Hospital SH.P.K me NUI 810800913. Administratori Falimentues me aprovimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas lëndës me numër FE. Nr. 11/22, Shpall shitjen përmes ankandit publik të veturave të përshkruara si më poshtë:

- Në këtë ankand shiten 6 automjete të cilat janë:
 - 3 vetura, Ford Fiesta me vitin e prodhimit 2012,
 - 1 veturë, Renault Z me vitin e prodhimit 2011
 - 1 autoambulancë, Citroen Jumper me vitin e prodhimit 2009
 - 1 minibus me 3 dyer, Mercedes Benz-Daimler Chrysler me vitin e prodhimit 2005.
- Afati për shiqimin e veturave** është deri me datën 07.09.2024.
- Adresa** ku gjenden veturat për të u shiquar është Rr. Nëna Terezë, Stacioni i Trenit, Fushë Kosovë (ish Fabrika e Miellit).
- Person kontaktues:** Genc Vitaku, me numër të tel: +38345983267.
- Dorëzimi dhe hapja e ofertave** bëhet me datë 09.09.2024 në ora 12:00.
- Ofertat** duhet dorëzuar në zarf të mbyllur.
- Dorëzimi i ofertave** bëhet në Prishtinë, Rr. Bekim Fehmiu, Lakrishtë, Ndërtesa "Arting", Kati 10, zyrja nr. 23.
- Me fituesin e ankandit do të lidhet kontrata për automjetet e blera.

>> SHBALLJE TË VOGLA <<

- Anel Rustemi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- Dardan Pulaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- Fiknete Pula shpall te pavlefshme dëftesën e kl IX Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Elma Popaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat , certifikatën , diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Besmir Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl - IX shfmu " Hamez Thaqi " Xerxe.
- Lavdim Dobërdoli shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.
- Valdet Bushati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të shkollës Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Blenisa Elezaj nga Ponoheci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Ganimete Tërbeshi" Ponoheci KK Gjakovë nga kl. 6-9.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE B.D.
N.P.L PËRPARIMI S.H.A. - VUSHTRRI
Nr. Protokolit: 109/24
Data: 03.09.2024

Në mbështetje të nenit 21.1 dhe nenit 25 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2021, lidhur me nenin 22 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 19.04.2018, e duke u bazuar në vendimin e Komisionit të Auditimit me nr. të protokollit 102/24 të datës 28.08.2024, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 03.09.2024, shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendit të lirë për pozitën e punës "Zyrtar për Auditim të Brendshëm")

I. Titulli: Zyrtar për Auditim të Brendshëm

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar në periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi të vazhdimit.

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet.

Përvoja e punës: Së paku tri (3) vite në kontabilitet dhe auditim.

I raporton: Komisionit të Auditimit.

Koeficienti i pagës: caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Kushtet e veçanta:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të përmbushë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) t'i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet ashtu si kërkohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të jetë Auditor i Certifikuar në sektorin publik, certifikatë e cila duhet të jetë e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në

pajtuemëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave, ashtu si kërkohet me nenin 22 Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.
- të ketë aftësi organizative dhe shkathtësi komunikimi;
- njohja e programeve Microsoft Office;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përpilimi i planit të auditimit të brendshëm të ndërmarrjes konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të bazuara në legjislacion të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve investive financiare, planit vjetor dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit, deklaratat e fitimeve dhe humbjeve, si dhe deklaratave financiare.
- Vlerësimi profesional i shfrytëzimit efektiv të burimeve të ndërmarrjes dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për komisionin e auditimit, përkatësisht menaxhmentin e ndërmarrjes.
- Bën kontrollin financiar të pasurisë dhe parave të gatshme
- Udhëheqë dhe organizon auditimin e brendshëm.
- Zbaton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Kryen detyrat e përcaktuara nga Komisioni për Auditim, dhe
- Kryen edhe punët tjera të nevojshme.
- Udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A (I cili merret në zyrën e Sekretarit të ndërmarrjes);
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2. (Kjo deklaratë merret në zyrën e Sekretarit të Ndërmarrjes);

- Rezime për jetëshkrimin e kandidatit;
- Letër Motivuese;
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (Diploma të sillet e noterizuar);
- Certifikata për Auditor të Brendshëm të lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Certifikata me të cilën dëshmohet se është ekspert në kontabilitet e lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe certifikatën nga gjykata me të cilën dëshmon se nuk është nën hetime, të dy (2) dokumentet të sillen në formë origjinale (jo më të vjetra se 6 muaj);

Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Sekretarit të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Aplikacioni duhet të dorëzohet në një kuvertë e cila duhet të jetë e mbyllur.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 04.09.2024 deri me datë 03.10.2024 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



U prilogu çlanu 21.1 i çlanu 25 taçka h) Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća objavljena u Službenom listu Republike Kosovo 15.06.2008, çlan 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća objavljena u Službenom listu Republike Kosovo 30.05.2021, u vezi sa çlanom 22 Zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 19.04.2018, a na osnovu odluke Komisije za reviziju br. protokola 102/24 od 28.08.2024, godine N.P.L "Përparimi" Sh. A, od 03.09.2024, saopštava:

JAVNI KONKURS

(Za popunu konkursa za radno mesto „Službenik za internu reviziju“)

I. Naslov: Službenik za unutrašnju reviziju

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od tri (3) godine, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija relevantnih za sektor koji će biti predmet revizije.

Radno iskustvo: Najmanje tri (3) godine u računovodstvu i reviziji. Izveštava: Odbor za reviziju.

Koeficijent plate: Utvrđuje se odlukom Upravnog odbora.

Posebni uslovi:

- Za ispunjavanje kriterijuma za službenike kompanije prema çlanu 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Da ispuni kvalifikacione uslove prema çlanu 17.1, (ii) da ispuni kriterijume nezavisnosti prema çlanu 17.2, taçke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Da bude ovlašćeni stručnjak za računovodstvo u skladu sa çlanom 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća;
- Biti ovlašćeni revizor u javnom sektoru, sertifikat koji mora da izda Ministarstvo finansija ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar finansija, kao i propisano çlanom 22. Zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija.
- Dobro poznavanje zakona i propisa koji su na snazi, sa posebnim osvrtom na Zakon o javnim preduzećima, Zakon o privrednim društvima, Zakon o unutrašnjoj kontroli javnih finansija, Zakon br. 06/L-032 o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji, kao i drugi zakoni koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama.
- Imati organizacione sposobnosti i komunikacione sposobnosti;
- Poznavanje Microsoft Office programa;
- Poznavanje stranih jezika je prednost;
- Da nije osuden ili pod istragom.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sastavljanje plana interne revizije kompanije u skladu sa ciljevima, politikama i procedurama interne kontrole na osnovu važećeg zakonodavstva.
- Revizija planova finansijskih investicija, godišnjeg plana i godišnjeg budžeta.
- Revizija godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspeha i finansijskih izveštaja.
- Stručna procena efektivnog korišćenja resursa preduzeća i davanje adekvatnih preporuka revizionoj komisiji, odnosno menadžmentu preduzeća.
- Vrsi finansijsku kontrolu imovine i gotovine
- Vodi i organizuje internu reviziju.
- Sprovodi sve aktivnosti interne revizije.
- Obavlja poslove koje odredi Komisija za reviziju, i
- Takođe obavlja i druge neophodne poslove.
- Vodi i usmerava sve aktivnosti interne revizije.
- Za svoj rad odgovara Odboru za reviziju.

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L "Përparimi" Sh. A (koji se prima u kancelariji sekretara preduzeća);
- Izjava potpisana od strane kandidata da ispunjava kriterijume nezavisnosti prema çlanu 17.1 i 17.2. (Ova izjava se prima u kancelariji sekretara preduzeća);
- Životopis za biografiju kandidata;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o univerzitetskoj kvalifikaciji (diploma mora biti overena);
- Sertifikat za internog revizora izdat od strane nadležnih organa, koji mora biti validan (Uverenje o važnosti sertifikata);
- Uverenje o stručnom znanju za računovodstvo izdato;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije osuđivan/a pravosnažnom presudom i uverenje suda kojim se dokazuje da nije pod istragom, oba (2) dokumenta moraju se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren trideset (30) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti formular za prijavu i izjavu pod zakletvom i predati je kancelariji sekretara N.P.L "Progres" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici - filijala u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Prijavu se mora predati u koverti koja mora biti zatvorena.

Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 04.09.2024 do 03.10.2024 u 16:00 časova.

N.P.L "Progres" Sh. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj. tel. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok će nepotpune prijave biti odbijene.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 04.09.2024

Referenca: AAPSK – 010/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Passat 3B, viti i prodhimit 2000, dizel, ngjyrë e zezë-për pjesë	1 copë / për pjesë	1,080.00€		
2	Golf III, viti i prodhimit 1995, benzin, ngjyrë e kuqe-për skrap	1 copë/ për skrap	176.98€		
3	Golf II, viti i prodhimit 1985, dizel ngjyrë e kuqe- për skrap	1 copë/ për pjesë	213.44€		
4	Citroen Berlingo, viti i prodhimit 2006, dizel, ngjyrë e hirit, pa targa	1 copë	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 11.09.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë, kurse pasuritë me numra rendor:4 mund ti shikoni me datë 10.09.2024 në Qendren Korrektuese Smrekovicë në ora 10:00-11:00

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 11.09.2024, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.,

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aaprk.gov.net> apo <https://md.rks.gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e i/e Lartë Ligjor
Grada e pozitës:	pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit
Raporton tek:	Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njësisë organizative të BQK-së përgatit konkurset për vende të lira pune.
- Monitoron afatet e vendimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit lidhur me emërimet me afat dhe përgatit plotësimin e vendimeve.
- Ofron shërbimet e sekretarisë së komisionit disiplinor dhe komisionit të ankesave të BQK-së.
- Drafton, rishikon dokumentet dhe aktet e departamentit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit duke përfshirë propozimin e politikave dhe rekomandimeve relevante të departamentit duke siguruar që ato të përputhen me ligjin dhe praktikën më të mira të punës.
- Ofron këshilla/opinione ligjore me kërkesë dhe brenda fushëveprimit të departamentit.
- Krijimi dhe ruajtja e dokumentacionit ligjor dhe administrative në përputhje me standardet dhe rregulloret e aplikueshme.
- Shqyrton kërkesat e paraqitura, identifikon rastet e tilla dhe jep rekomandime profesionale për veprime të mëtejme.
- Ndërmerr veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësi të deleguara.
- Ruan sekretin dhe informacionin në përputhje me aktet ligjore të Bankës.
- Informon mbikëqyrësin e vet mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to.
- Bashkëpunon me departamentet tjera për zgjidhjen e çështjeve të ndërlukuara ligjore që kanë të bëjnë me punën dhe punësimin.
- Kryen punë tjera administrative që kanë të bëjnë me personelin.
- Promovon barazinë dhe diversitetin si pjesë e kulturës në Bankë.
- Kryen detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë apo juridike - Fakulteti Juridik ose ekuivalent.
- Njohje e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në njohjen e Ligjit të Punës, Ligjit për Bankën Qendrore, dhe politikave të burimeve njerëzore.
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.
- Njohje e aplikacioneve të MS-Office.

Përvoja e kërkuar:

- Minimum 3 vite përvojë pune (të dëshmuara) profesionale në fushën juridike. Përvoja e kërkuara në fushën e burimeve njerëzore do të jetë përparësi.

Kërkesat e posaçme:

- Shkathtësi humlultuese, analitike, vlerësuese dhe shkrim ligjor (formulim të shkresave rekomandimeve dhe opinioneve ligjore).
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi.
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e çështjeve sipas prioriteteve.
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore.
- Përgjegjshmëri dhe integritet në menaxhimin e informacionit të ndjeshëm dhe të përshkallëzuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **18 shtator 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Viši pravni službenik
Stepen pozicije:	pet (5)
Trajanje radnog odnosa:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	za ljudske resurse i razvoj
Izveštava:	direktoru Odeljenja za ljudske resurse i razvoj

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- U saradnji sa rukovodiocima organizacionih jedinica CBK-a priprema konkurse za slobodna radna mesta.
- Prati rokove donošenja odluka Izvršnog odbora i guvernera u vezi sa imenovanjima u roku i priprema dopunu odluka.
- Pružna usluge sekretarijata disciplinske komisije i komisije za žalbe CBK-a.
- Izrađuje, pregleda dokumente i akte odeljenja za ljudske resurse i razvoj, uključujući predlaganje relevantnih politika i preporuka odeljenja kako bi se osiguralo da su u skladu sa zakonom i najboljom radnom praksom.
- Daje pravne savete/mišljenja na zahtjev i u okviru delokruga odeljenja.
- Izrada i vođenje pravne i administrativne dokumentacije u skladu sa važećim standardima i propisima.
- Razmatra podnesene zahteve, identifikuje takve slučajeve i daje stručne preporuke za dalje postupanje.
- Preduzima pravne radnje u okviru delegiranih ovlašćenja i odgovornosti.
- Čuva tajnost i informacije u skladu sa zakonskim aktima Banke.
- U kontinuitetu obaveštava svog pretpostavljenog o rezultatima rada i o poteškoćama u vezi s njima.
- Sarađuje sa drugim odeljenjima na rešavanju složenih pravnih pitanja vezanih za rad i zapošljavanje.
- Obavlja i druge administrativne poslove koji se odnose na osoblje.
- Promoviše jednakost i raznolikost kao deo kulture Banke.
- Obavlja i druge dodeljene poslove po zahtevu pretpostavljenog.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava - Pravni fakultet ili ekvivalent.
- Poznavanje važećih zakona u Republici Kosovo sa posebnim naglaskom na poznavanje Zakona o radu, Zakona o Centralnoj banci i politike ljudskih resursa.
- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.
- Poznavanje MS-Office aplikacija.

Potrebno iskustvo:

- Minimalno 3 godine (dokazanog) profesionalnog radnog iskustva u pravnoj oblasti. Potrebno iskustvo u oblasti ljudskih resursa predstavljaće prednost.

Posebni zahtevi:

- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i veštine pravnog pisanja (formulisanje pisama preporuke i pravnih mišljenja).
- Pažnja prema detaljima, prema jasnim formulisanjima i tačnost.
- Veštine komunikacije u pisanju kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima.
- Samoinicijativnost i spremnost za timski rad.
- Odgovornost i integritet u upravljanju osetljivim i eskaliranim informacijama.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Poslednji rok za podnošenje prijave je **18 septembar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali načini za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1904

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L



TRADITË QË NGA 1992

